



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 13.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNP STANDARD" për aktivitetin: "Ndertimi i QMF-se ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NNP STANDARD" e datës 11.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i QMF-se ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 07.08.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Anulohet *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 07.08.2020 dhe aktiviteti kthehet në rivlerësim;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Standard**" me datë 11.08.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndertimi i QMF-se ne Veternik**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511

Autoriteti Kontraktues, me datë 13.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet lidhur me plotësimin e kërkesave të stafit në bazë të të cilave është refuzuar tenderi i pretenduesit janë të bazuara, pasi që është konstatuar se komisioni gabimisht është bazuar vetëm në deshmite të stafit të njerit nga anëtarët e konzorciumit ("Arifaj") e jo edhe në deshmite të dorëzuara nga anëtarët tjerë: "NTP STANDARD". Nga deshmite të dorëzuara nga i njëjti shihet qartë se i njëjti ka dorëzuar deshmite të stafit në harmoni me kërkesat e FDT-se.

Nga konstatimet paraprake rrjedh se ne fazen e rivleresimit duhet te ekzaminohen te gjitha deshmita e dorezuara nga te gjitha anetaret e grupit-konzorciumit dhe te permbyllet procesi duke u bazuar ne kerkesat e FDT-se.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

